

# Shpërfillet Udhëzimi Administrativ për funksionimin e KKSBB-së

Arian Duriqi

LIPJAN, 18 QERSHOR – Një Udhëzim Administrativ para një viti i adresuar nga Ministria e Pushtetit Lokal për komunat e vendit dhe që flet për formimin, funksionimin dhe mbarëvajtjen e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, sipas shoqërisë civile në Lipjan nuk po re-

spektohet nga autoritetet e kësaj komune. Dhe, dy janë shkaqet pse ka reaguar shoqëria civile ndaj kësaj shpërfilljeje. E para, KKSBB-ja nuk ka mbajtur asnjë debat me qytetarë me gjithë faktin se Udhëzimi Administrativ parasheh dy të tillë gjatë një viti, derisa shkak tjetër është fakti se Zyra e Personelit në këtë komunë po zvarrit pagesën e mëdit-

jeve për anëtarët e këtij organi, apo për ata që s'marrin paga nga buxheti i vendit.

“KKSBB-ja nuk ka mbajtur asnjë takim me qytetarë edhe pse dy të tilla janë paraparë gjatë një viti. Dhe, përderisa gjysma e parë e vitit ka kaluar dhe nuk është menduar për këto takime, ne publikisht u bëjmë vërejtje autoriteteve komunale për këtë shpërfillje të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së që rregullon funksionimin e KKSBB-së”, ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut – YAHR. “Një tjetër element që tregon për mosrespektim të udhëzimit në fjalë është edhe mospagesa e mëditjeve për anëtarët e KKSBB-së, që po ashtu rregullohet me udhëzim. Zyra e Personelit e ka zvarritur shumë këtë punë dhe kështu shpërfill udhëzimet që vijnë nga lartë”, ka shtuar ai.

Mirëpo, zyrtarët komunalë nuk po e shohin shpërfillje të UD-së funksionimin aktual të KKSBB-së, por pamundësi buxhetore për të realizuar mëditjet.

“Ne po presim që nga niveli qendror të rregullohet çështja e pagesave të mëditjeve për anëtarët e KKSBB-së, sepse Zyra e Personelit ka deklaruar se nuk është kjo çështje që u takon atyre”, ka thënë Hasan Luma, shef në Zyrën e Informacionit publik, ndërsa ka përgjigje edhe për debatet publike.

“Në debatet me qytetarë që mbanë kryetar i Komunës së paku dy herë gjatë një viti ftohen edhe drejtuesit e anëtarët e KKSBB-së, që do të thotë se kryetari i Komunës është edhe kryesues i KKSBB-së dhe mbanë debatet me qytetarë njëkohësisht”, ka thënë ai.

Megjithatë, shoqëria civile nuk po pajtohet që të përzihet debati që organizon kreu komunal me atë që do të duhej bërë KKSBB-ja. Krasniqi (YAHR) thotë se nuk do të duhej të kishte këso lloj përzjeresh.

“Ata (autoritetet komunale) po i përziejnë debatet me qytetarë që organizojnë, sepse Udhëzimi Administrativ që rregullon funksionimin e KKSBB-së e thotë qartë se ky organ duhet të mbajë së paku dy herë në vit takim me qytetarë dhe askund nuk thotë se njëherësh mund të mbajë debat edhe Komuna edhe KKSBB-ja, por veçmas”, është shprehur Krasniqi.

Për më tepër, ka gati dy muaj qysh kur është mbledhur herën e fundit KKSBB-ja. Dhe, përderisa praktikat e kaluara nuk flasin për takimet e KKSBB-së në çdo të dytin apo të tretin muaj, nga ana tjetër kohëve të fundit ka pasur anëtarë të këtij organi që kanë paralajmëruar edhe bojkot të mbledhjes kurdo që mbahet në qoftë se s'ka ndonjë përgjigje konkrete për mëditjet.



“KKSBB-ja nuk ka mbajtur asnjë takim me qytetarë edhe pse dy të tilla janë paraparë gjatë një viti. Dhe, përderisa gjysma e parë e vitit ka kaluar dhe nuk është menduar për këto takime, ne publikisht u bëjmë vërejtje autoriteteve komunale për këtë shpërfillje të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së që rregullon funksionimin e KKSBB-së”, ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut – YAHR